

gane". Pastaj më propozon edhe gjësent tjetër: "S' mun me i thanë me më çu prej Amerike - nji tyrbi? Unë po i fal diçka." Edhe këtë shpresë ja preva, dyke i thënë se këta miq të huaj nuk ishin milionarë siç e pandente miku i im modern. Për fat të mirë arrimë ke vau i Fanit të Mach dhe kështu u ndamë atje me një mijë fjalë t' ëmbëla! Më mërziu me ato fjalë, pa kisha frikë se mos mendja e tij i pillte edhe të tjera t' asaj nature.

Për fat të mirë uja e Fanit nuk ish shumë, tjetërsoj do të mos munim të kalojmë vaun i cili në disa vënde ish edhe i fellë. Kishim frikë se mos na merte no një mushkë me gjithë instrumentat pa të cilat s' bënim as një çap.

Me tik tak në zemër — i meren mëntë njeriut kur është mi kafshë edhe kalon një ujë me rëmbim! — duallm për tej Fanit kaluar. Qiraxhinjtë e kapërxyen dyke qënë të çveshurgjer në mes.

Prej vaut filluam t' ja marim të përpjetës edhe duallm në Gojan, ku gjejmë udhës një plak copë copë; mi këtë burrë të mjerë do flas në një tjetër kaptinë. Dyke lënë më të mëngjër bjeshkën e Gojanit edhe majën e Suçelit po vinim më të lartër gjithëmonë edhe u afërohem shim kufive Pukë - Mirditë.

Qiraxhinjtë tani po mërziteshin edhe më